

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot, më 01 / 08 / 2018, në Tiranë,

QENDRA 'SOL', me adresë në Tiranë, Rajoni 5, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Z. Gëzim BEGOLLI;

DHE

KOLEGJI BIZNESI PRISHTINE, KOSOVE (në vazhdim referuar si Universiteti) me adresë në Prishtinë : "1000 Prishtine Ulpiane, Motrat Qiriazhi 29 Str ", përfaqësuar nga Prof Shyqeri Kabashi,

Kanë rënë dakort të hartojnë dhe të nënshkruajnë këtë Marrëveshje bashkëpunimi për të vendosur bashkëpunim të vazhdueshëm sipas termave të mëposhtme:

I. Qëllimi i bashkëpunimit

Duke dakortësuar që është interesi i tyre i përbashkët, palët angazhohen sipas kësaj marrëveshjeje me qëllim kryesor:


- Të promovojnë dhe të zhvillojnë bashkëpunim në kërkim dhe mësimdhënie shkencore në institucionet e tyre;
- Të krijohen mekanizmat e nevojshme organizative për bashkëpunim të vazhdueshëm.
- Të krijohen mundësi kontaktesh e shkëmbimesh me institucione të tjera akademike brenda dhe jashtë Shqipërisë.

II. Angazhimet e palëve

Në mënyrë që të arrihen qëllimet e përbashkëta të kësaj marrëveshjeje, secila nga palët angazhohet për të ndërmarrë veprime organizative dhe administrative, kryesisht por duke mos u kufizuar në :

A. Sa i përket Qendres 'SOL':

- Do të kryejë veprimet e nevojshme për të rekrutuar student, bazuar në autorizimin e



dhënë nga Universiteti , si janë: shpërndarje e materialeve, intervistimi I studentëve potencialë, ofrimi I asistencës për studentët në plotësimin e aplikimeve dhe dokumentave të tjerë të nevojshëm për pranim në universitet.

- Menaxhon dhe kordinon leksjone ndermjet universiteteve sipas nevojave të tyre.
- Menaxhon dhe organizon seminare dhe trajnime (shkëmbim përvije profesionale)
- Menaxhon dhe organizon përgatitje dhe udhëheqje për profesor dhe studentë;
- Do të ndër marrë veprime për të nxitur aftësitë e studentëve, si:
 - Koordinon dhe organizon shkolla verore ;
 - Organizon udhëtime me grupe miks studentësh;
- Do të ndër marrë veprime për të ndihmuar studentët , si:
 - Sugjerim I temave për tema diplome për student të ciklit bachelor apo master ashtu si edhe për të lehtësuar kontaktet ndermjet studentëve dhe profesorëve;
 - Sugjeron mundësi të ndryshme për programe internship;
 - Sugjeron dhe përkrah për punësim të përkohshëm për studentët me rezultate të shkëlqyera.

B. Sa I përket Universitetit :

- I ofron Qendrës Sol autoritet për të pasur të gjitha kapacitetet për të vepruar në emër të Universitetit për sa I takon rekrutimin dhe ndihmës së tyre përgjatë periudhës së viteve akademike;
- Ofron Qendrës Sol dokumentat e përshtatshme si: Brochura , postera, katalogë ashtu si edhe dokumenta të tjerë të nevojshme për studentët e ardhshëm si formatet e aplikimit , lista e kërkesave për pranim në universitet.

III. Terma financiare

Sa I përket kostove të veprimeve dhe shpenzimet e tjera , palët bien dakort :

- Kostot e seminareve do të përballohen nga universitetet pjesmarrëse në mënyrë të barabartë.



- Aktivitetet e seminareve do të jenë pa pagesë (me qëllim shkëmbim përvoja profesionale), me përjashtim të rasteve kur janë ftuar për të marrë pjesë profesorë të jashtëm .
- Universiteti do te paguaje Qendren Sol me nje shumë prej 5 % (pesë pëqind) të tarifës shkollore që paguan student i regjistruar për universitetin. Kjo shumë I paguhet Qendres Sol me qëllim mbulimin e shpenzimeve për kurset dhe aktivitetet me qëllim social kulturor që kjo Qender organizon , përtej aktiviteteve të ndërmarra në bazë të kësaj marrëveshje.
- Kostoja e veprimeve të ndërmarra për të nxitur aftësitë e studentëve si edhe veprimeve për të ndihmuar studentët , që kryhen nga Qendra Sol , si eshte përshkruar në nenin II më sipër, përballohen nga vetë studentët pjesmarrës dhe përcaktohet bazuar në koston totale të aktivitetit dhe donacioneve, nqse ka.

IV. Protokollet e mundshme të kësaj marrëveshje

Për të arritur qëllimet e kësaj marrëveshjeje , palët mund të nënshkruajnë marrëveshje specifike sipas legjislacionit përkatës për të rregulluar të gjitha aspektet e iniciativave specifike.

Çdo protokoll marrëveshje duhet të aprovet dhe nënshkruhet nga autoritetet kompetente të palëve. Në përgjithësi, por jo detyrimisht, çdo protokoll duhet të përmbajë:

- Objektivat që duhet të arrihen dhe aktivitetet specifike për t u zhvilluar;
- Materialet dhe strukturat e nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve ;
- Detyrimet ekonomike potenciale dhe plan financiar nëse eshte e nevojshme;
- Modalitetet e shkëmbimit të stafit të përfshirë në aktivitet ;
- Parashikime për të mbuluar kostot e udhëtimit, qëndrimit të pjesmarrësve;
- Mbulimi I siguracionit shëndetësor;
- Subjekti dhe emertimi I rezultateve qe pritet te arrihen nga zhvillimi I iniciativës përkatëse (nëse është e nevojshme) ;
- Shtyrja e afateve ;
- Elementë të tjerë të nevojshëm për rregullimin e realizimit të aktiviteteve.

[Signature]

3 *[Signature]*

V. Afati I marrëveshjes

- Kjo marrëveshje është e vlefshme për një afat 5 (pesë) vjeçar duke filluar nga data e nënshkrimit nga të dy përfaqësuesit e palëve të marrëveshjes.
- Kjo marrëveshje mund të shtyhet apo rinovohet me marrëveshje të palëve, sipas aprovimit të autoriteteve kompetente përkatëse.

VI. Ndryshimi dhe përfundimi I marrëveshjes

- Cdo parashikim I kësaj marrëveshje mund të ndryshohet ose shfuqizohet në çdo kohë me dakortësinë dhe mirëkuptimin e përbashkët të palëve.
- Inisiativa për të hequr dorë nga kjo marrëveshje mund të paraqitet nga secila prej palëve në çdo kohë, me një njoftim të paktën 4 (katër) muaj përpara.
- Veprimtaritë në vazhdim nuk ndikohen nga dorëheqja , por duhet të rregullohen nga protokollet përkatëse të veprimit.

VII. Dispozita përfundimtare

Kjo marrëveshje hartohet dhe nënshkruhet në tre kopje origjinale, një në gjuhën Shqipe dhe dy në Anglisht dhe kjo ka forcën e ligjit për të dy palët.

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, Universiteti jep të gjitha kompetencat e nevojshme dhe autorizimin për Qendrën Sol për të vepruar në emër të Universitetit ashtu si përshkruhet në këtë marrëveshje.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin e saj nga palët.

SOL CENTER

Përfaqësuar nga :

Geam Bejollu
Bejollu



Kolegji Biznes Prishtine

përfaqësuar nga

Shyqyri Kabonli

